



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 21, datë 26.04.2022

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT “ZALL XHUXHË NR. 1” DHE “ZALL XHUXHË NR.
2”, NË KASKADËN E PËRROIT TË ZALL XHUXHËS, DEGË E LUMIT FAN I VOGËL”,
BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë koncesionare “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Ndërtimi i Hidrocentralit “Zall Xhuxhë Nr. 1” dhe “Zall Xhuxhë Nr. 2”, në kaskadën e përroit të Zall Xhuxhës, degë e lumit Fan i Vogël”, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve bashkëlidhur Kontratës së Koncesionit të amenduar.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.13, datë 03.10.2018, nuk ndryshon.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

